



Prishtinë, 25 nëntor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_864_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V-660-2014 të datës 11 nëntor 2014 për shoqërinë “Matkos Group” Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpçës;
- Kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014 edhe për një (1) vit, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpçës, të datë 10.11.2016 të shoqërisë “Matkos Group” Sh.p.k., me adresë rruga “Veternik” 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 25 nëntor 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014, i shoqërisë “Matkos Group” Sh.p.k., për Hidrocentralin HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, ZK Drekoc, komuna e Shtërpçës, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **11 nëntor 2017 për përfundimin e ndërtimit.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 29.03.2013 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, për katër (4) njësi gjeneruese, HC Shtërpçe me



kapacitet të instaluar prej 2.47 MW, HC Bitinje 2.1 MW, HC Vica 2.5 MW dhe HC Brod 2.5 MW, të gjitha në Komunën e Shtërpcës.

- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k.ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_541_2013 me datë 28 qershor 2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 19.06.2014 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim Final për HC Bitinje dhe HC Vica të bashkuar në një Hidrocentral me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, në lokacionin “Dregoc”, në Lumin Lepenc ZK Drekoc, Komuna e Shtërpcës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 11.11.2014 ka vendosur që shoqërisë “Matkos Group” Sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi Final V_660_2014 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin Drekoc, ZK Drekoc Komuna e Shtërpcës.
- ZRRE me datë 10.11.2016 nga shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_660_2014 të datës 11 nëntor 2014, për HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 11 nëntor 2017.**
- Shoqëria “Matkos Group” Sh.p.k., në kërkesën e saj ka sqaruar se: *gjatë kësaj periudhe për projektin HC Vica kanë hasur në pengesa nga Komuniteti Shqiptar i asaj zone përkundër organizimit të debatit publik që ishin organizuar dhe mos pjesëmarrja e tyre në debat publik, ka bërë që ata të mos jenë të informuar për projektin, dhe në momentin e fillimit të punimeve fillestare është organizuar një protestë për të penguar investimet në realizimin e projektit.*
- *Gjithashtu përkundër pengesave të paraqitura nga ana e komunitetit, në bazë të ankesave të tyre drejtuar Inspektoratit të Ndërtimit, pengesa janë paraqitur edhe nga Inspektorati i Ndërtimit i cili fillimisht pas inspektimit ka sjellur vendimin për ndërprerje të punimeve. Pas parashtrimit të Ankesës nr. 06/2015 dt. 28.08.2015 Inspektorati i Ndërtimit me datë 04.09.2015 sjellë Njoftimin me të cilën e lejon subjektin juridik që të vazhdon me punët ndërtimore.*
- *Po ashtu, janë paraqitur pengesa edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila me datë 25.09.2015 sjellë Konkluzionin me të cilën e ka obliguar subjektin afarist që në*



afat prej 60 ditësh të hartoj Studimin e Prurjeve të Pranueshme Ekologjike. MMPH pas hartimit të studimit të kërkuar, me datë 07.03.2016 ka sjellur Pëlqimin Ujor Nr. 732-3/14-ZSP-335/2016 me të cilën ka aprovuar plotësimin e kushteve të "Ndryshimi i Vendimit –Pëlqimit Ujor" Nr. 3449-2/14-ZSP-1178 të datës 28.10.2014.

- Shoqëria "Matkos Group" Sh.p.k., ka sjellur edhe njoftimin nr. 06-16-9843 dt. 10.11.2016 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Shtërpcës, ku ka sqaruar arsyet e ndërprerjes së punimeve për këtë periudhë, të cilat kanë ndaluar si pasojë e ankesave të banorëve lokal, të cilët kanë bërë pengesa në fillimin e punimeve në realizimin e projektit të HC Vica. Gjithashtu ka sqaruar se gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe takime me përfaqësuesit e MMPH-së, dhe me qytetarët lokal për dhënien e shpjegimeve të domosdoshme lidhur me projektin.
 - Po ashtu në njoftimin përkatës të Komunës së Shtërpcës është kërkuar nga ZRRE që të merr për bazë situatën e krijuar gjatë kësaj periudhe kohore, në mënyrë që të mund të rivendos afatet e përcaktuara për investitorin, dhe njëkohësisht ka kërkuar mirëkuptimin e investitorit për humbjen e kohës në realizimin e projektit, se me këtë rast janë krijuar kushtet e përshtatshme për rifillimin e punimeve, duke shpresuar se janë tejkaluar paqartësitë rreth këtij projekti. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve të lartcekura ka sqaruar se, nuk kanë arritur ti fillojnë punimet respektivisht të vazhdojnë me punët ndërtimore brenda afatit kohor, dhe kanë kërkuar që t'iu mundësohet vazhdimi i Autorizimit Final konformë mundësive ligjore dhe rregulloreve në fuqi.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës dhe dëshmimeve të bashkangjitura për shtyerje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, të shoqërisë "Matkos Group" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc HC Vica me kapacitet të instaluar prej 4.6 MW, në Komunën e Shtërpcës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se për shkak pengesave të paraqitura në ndërtimin e këtij hidrocentrali të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V-660-2014 i datës 11 nëntor 2014, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_660_2014 i datës 11 nëntor 2014, do të shfuqizohet me datë **11 nëntor 2017**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, U.D. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së